

RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR PËRMES GJUHËS SHQIPE NË MËRGATËN NË BULLGARI, UKRAINË, RUMANI DHE TURQI

Kurtesh DEVAJA

Përmbledhje

Zhvillimet historike, shpesh edhe tragjike në gadishullin e Ballkanit, siç ishin luftërat, persekutimi dhe torturimi i egër nga pushtuesit e ndryshëm, në vazhdimësi krijuan rrethana të vështira, madje edhe tragjike për shqiptarët. Duke mos mundur t'i përballojë këto fatkeqësi, një pjesë e kombit tonë u detyrua që të zhvendosej nga vatrata e veta dhe migroi për të gjetur strehë në shtetet fqinje, por edhe në vende më të largëta. Sot bota e di ku jemi, se ne dhe historia jonë datojnë që nga pellazgët, ilirët, arbërit dhe shqiptarët. Nëse u referohemi të dhënave demografike, burimeve historike, studiueseve dhe autorëve të ndryshëm, mund të nxirret një konkluzion i përafërt, por jozyrtar, se në gjithë globin, numri i shqiptarëve sillet mbi 15 milionë, por mund të jetë edhe 20 milionë.

Sigurisht që numri nuk mund të jetë i saktë, pasi është e pamundur të bëhet numërimi i të gjithë shqiptarëve autoktonë ose emigrantë. Shifrat mund të jenë më të mëdha apo më të vogla, sepse shqiptarët janë të shpërndarë nëpër shtete të ndryshme, ku më pak e ku më shumë.¹⁰¹ Mërgata shqiptare në botë luan rol të rëndësishëm për sa i përket ruajtjes së identitetit dhe gjuhës shqipe në shtetet e ndryshme ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët. Këtë çështje e kam shtjelluar gjerësisht në librat që kam botuar vitet e fundit, pas hulumtimeve që kam bërë në shtetet ku shqiptarët migruan në masë. Fokusi im është përqendruar në ruajtjen e identitetit kombëtar përmes gjuhës shqipe të shqiptarëve që jetojnë në Bullgari, në Ukrainë, në Rumani e vende të tjera. Mërgimtarët tashmë kanë formuar shoqatat e tyre edhe në vendet më të largëta.¹⁰²

Ruajtja e identitetit dhe gjuhës është parësore

Shqiptarët në Bullgari

Ngulmimet e shqiptarëve në Bullgari datojnë që prej viteve 1400, ndërsa të dhënat e rëndësishme dhe të detajuara për këtë tematikë ndodhen në arkiva, ku janë të sistemuara dokumente në gjuhën shqipe ose për gjuhën shqipe. Sa u përket ngulimeve fillestare të shqiptarëve, të cilat janë bërë në Bullgari, veçohet Bullgaria Veriore, si Arbanasi, Chervena Voda dhe disa vendbanime të tjera, ku popullata shqiptare aty ka migruar gjatë kohës së kryengritjeve antiosmane dhe luftërave ruso-osmane.¹⁰³ Në vendbanimet ku sot jetojnë shqiptarët, kanë mbetur gjurmë të ndryshme.

¹⁰¹ Kurtesh Devaja, *Mbijetesa e shqiptarëve në Ballkan*, shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë, 2019, f. 229-230.

¹⁰² Po aty.

¹⁰³ Kurtesh Devaja, *Me shqiptarët në Bullgari*, 2018, f. 35-36.

Veçohet kolonia shqiptare në Sofje, në të cilën përfshihen Gorno Arbanasi dhe Dollno Arbanasi afër Asenovgradit, me komunitetin më të madh shqiptar, që jeton në fshatin Mandricë.¹⁰⁴ Komuniteti shqiptar në Bullgari i takon edhe merita më e madhe për Rilindjen shqiptare, në të gjitha aspektet e saj në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, duke trashëguar një arkiv shumë të pasur - gazeta, libra, memorandume edhe dokumente të tjera në gjuhën shqipe - e që me kalimin e viteve janë hulumtuar nga shkencëtarë si Bojka Sokollova, Georgi Georgiev e shumë të tjerë. Dokumentet e këtylla kryesisht ndodhen në Arkivin Qendror të Shtetit, pastaj në Bibliotekën Kombëtare në Sofje, por ka dokumente edhe në arkivat dhe bibliotekat rajonale të shtetit bullgar.¹⁰⁵

Gjatë hulumtimeve të mia në fshatin Mandricë në Bullgari, kam nxjerrë konstatimin se sot atje jetojnë kryesisht banorë të moshës së shtyrë e më pak të rinj, sepse ata tani jetojnë në qytetet e mëdha të Bullgarisë. Banorët e sotëm të Mandricës përbëjnë brezin e fundit që flasin toskërishten e vjetër. Ata thonë se ajo që i mban të gjallë shqiptarët në Mandricë, dhe përgjithësisht në Bullgari, është gjuha shqipe. Ata të gjithë flasin shqip, por pjesa më e madhe e tyre nuk dinë të shkruajnë as të lexojnë në shqip, ndërsa në të folur e përdorin gjuhën arkaike.¹⁰⁶

Në studimet e mia lidhur me dialektin shqiptar të Mandricës, kam theksuar se komuniteti shqiptar në Bullgari e flet toskërishten e vjetër. Pos Mandricës vendet e tjera në veri të Bullgarisë, ku prania shqiptare ka qenë e fortë dhe më e ndjeshme janë: Chervena Voda afër Rousses, Poroishte afër Razgradit, Dobrina afër Provadias dhe Devnya afër Varnas. Do të thosha se duhet të përgëzohen pasardhësit e tyre që jetojnë sot në Sofje dhe në qytete të tjera në Bullgari, të cilët kanë krijuar shoqata aktive të shqiptarëve, për të folmen e shqiptarëve atje, si edhe për zakonet, për folklorin e trashëgimi të tjera të shqiptarëve atje. Më herët janë bërë hulumtime nga studiues të spikatur si Dhimitër Shuteriqi, Bojka Sokollova, Petja Asenova, Rusana Bejleri, Ludmill Stankov, Anton Pançev e të tjerë.¹⁰⁷

Shqiptarët në Bullgari kanë filluar të merren me shkrim-lexim në gjuhën amtare në fund të shekullit XX. Ka qenë Dhimitër Molle, i cili në vitin 1886, në Sofje ka sjellë librat e parë në shqip. Shumica e veprimtarëve shqiptarë në Bullgari kanë qenë të ardhur nga trojet juglindore të Shqipërisë, dhe kjo është arsyeja që ata i kanë përdorur variantet e toskërishtes së vjetër dhe në shkrimet e tyre kanë përkrahur ngritjen e standardit të shqipes mbi veçoritë e këtyre varianteve. Në sferën politike bullgare janë përdorur edhe disa variante të gegërishtes. Shembulli më i mirë ka qenë veprimtaria letrare dhe publicistike e Josif Bagerit dhe e Thoma Kacorrit.

Në këto veprimtari prezantoheshin dhe analizoheshin pikëpamjet e rilindësve shqiptarë në Bullgari, që kishin të bënë me alfabetin dhe standardin e gjuhës shqipe në fillim të shekullit XX. E gjithë veprimtaria bazohej në hulumtimin e gjuhës nëpër gazetat shqiptare, si “Drita”, “Shqypeja e Shqyppenisë” etj., pastaj mbi burime arkivore dhe veprat e rilindësve shqiptarë, që botoheshin gjatë kësaj periudhe në Bullgari.¹⁰⁸ Pra, në Bullgari nga ata pak shqiptarë të mbetur flitet shqipja sipas një fjalori bullgaro-shqip, ku gjuha e vjetër shqipe është e ngjashme me gjuhën dhe dialektin që e përdorin banorët e parë nga atdheu i tyre i origjinës - Shqipëria.¹⁰⁹

¹⁰⁴ Po aty.

¹⁰⁵ Dr. Bojka Sokolova, *Shkrime për bashkëpunimin e shqiptarëve në Bullgari*, 1979, f. 75.

¹⁰⁶ R. Bozhillova, *Vepër e përmbledhur*, f. 27.

¹⁰⁷ Dokumente arkivore: *Shtetësia bullgare*, 29-91.

¹⁰⁸ Kurtesh Devaja, *Me shqiptarët në Bullgari*, 2018, f. 235-236.

¹⁰⁹ Dhimitër Shuteriqi, *Studime filologjike*, viti 1963, f. 103-141.

Kontribut të rëndësishëm për afirmimin e veprimtarisë së shqiptarëve në Mandricë kanë dhënë: Ramazan Bogdani, prof. Llukan Tase, Abdylrahman Myftiu, albanologu dhe ish-diplomati bullgar prof. Ludmill Stankov. Ka edhe të tjerë që janë marrë me studimin e gjuhës shqipe në Bullgari.¹¹⁰ Prof. Ludmill Stankov ka botuar një libër në gjuhën bullgare me titull “Gjuha shqipe”, në të cilin jep pasqyrën e plotë të gjithë gramatikës së shqipes, duke e përfshirë në një studim të gjerë shkencor.¹¹¹ Ai në vitin 2016, ka botuar një libër tjetër kushtuar fshatit Mandricë, pikërisht në përvjetorin e lindjes së studiuesit shqiptar Dhimitër Shuteriqi.

Për botimin e librit të tij, siç thotë edhe vetë ai, është frymëzuar nga studimi i Dhimitër Shuteriqit për të folmen e mandricasve. Libri i Ludmill Stankovit, “E folmja shqipe e fshatit Mandricë”, fillon me të dhëna për historikun e fshatit. Stankov thotë se shtëpitë dykatëshe tregojnë edhe zanatin kyç të banorëve, rritjen e krimbit të mëndafshit, për të cilin ishin të nevojshëm kultivimi i pemëve të manit dhe ngritja e katit të sipërm të shtëpive për përpunimin e mëndafshit.

Në librin e tij “E folmja shqipe në fshatin Mandricë”, Ludmill Stankov ka përmbledhur të dhëna historike për themelimin e Mandricës. Në Universitetin “Shën Kliment Ohridski” në Sofje, punon dega me programin e studimit të shqipes në kuadër të katedrës “Gjuhësi e përgjithshme, indoevropiane dhe ballkanike”. Në fakt, Departamenti i Ballkanistikës, i krijuar në vitin 1994, administron degën e gjuhës shqipe dhe letërsinë shqiptare, si lëndë e detyrueshme. Mësimdhënës i dalluar i shqipes ishte Thoma Kacorri e tani janë Sofija Popova, Zoja Kostadinova, ndërsa në krye të studimeve shqiptare është prof. Rusana Bejleri. Viteve të fundit ka pasur mjaft interesim për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Bullgari. Në degën e gjuhës shqipe në Universitetin e Sofjes, çdo vit pranohen mbi 15 studentë që mësojnë shqip, së bashku me letërsinë përkatëse dhe shumë lëndë të tjera nga fusha e historisë, gjuhësisë e kulturës shqiptare.

Në kërkim të dritës - Shqiptarët në Ukrainë

Edhe në Ukrainë, sikurse në Bullgari, janë të ngulitur me mijëra shqiptarë që kanë krijuar komunitetin e tyre, të cilët kryesisht jetojnë në zonën e maleve të Buxhakut, si dhe në zonën e Zaporozhjes. Gjatë hulumtimeve që kam bërë atje në vitet 1970, 2005, pastaj në vitin 2011, por edhe më herët, kam konstatuar se shqiptarët në Ukrainë janë vendosur në shekujt XVII-XVIII e XIX. Ata para shumë vitesh kanë ardhur nga Bullgaria Lindore, përkatësisht nga rajoni i Dobrinës, së bashku me komunitetin Gagauz, përkatësisht selxhuk-turk, duke u vendosur në tokën e Besarabisë dhe në brigjet e detit Azov, duke krijuar vendbanimet e tyre në Karakurt, afër qytetit të Bollhardit dhe në qytetin e Odesës, si dhe në zonën e Zaporozhjes.

Gjatë hulumtimit tim, në Odesë kam hasur në dy rrugë që dëshmojnë praninë e hershme të shqiptarëve në këtë qytet, siç janë Rruga e Arnautit të Madh dhe Rruga e Arnautit të Vogël, që edhe sot e kësaj dite ndodhen të paprekura në Odesë. Duhet përmendur se në Odesë deri vonë, ka ekzistuar qendra kulturore shqiptare “Rilindja”.¹¹² Në jug të Ukrainës, pos Karakurtit, ekzistojnë edhe fshatra të tjera shqiptare, si Tjushki, Gjandran, Tazi dhe Gramovka, që janë shtrirë në zonën e Zaporozhjes. Nga rrëfimet e shqiptarëve atje, konstatohet se ajo që i ka mbajtur të gjallë ata, ishte dhe mbetet gjuha shqipe, e cila flitet kryesisht në fshatrat në jug të Ukrainës: në Karakurt, në qarkun e Odesës, dhe në qarkun e Zaporozhjes.

¹¹⁰ Kurtesh Devaja, *Me shqiptarët në Bullgari*, 2018, f. 336-337.

¹¹¹ Ludmill Stankov, *Gjuha shqipe*, f. 237.

¹¹² Kurtesh Devaja, *Në kërkim të dritës - Shqiptarët e Ukrainës*, 2017, f. 89-110.

Bazuar në burimet jozyrtare deri në vitin 2001, në territorin e Ukrainës banonin rreth 3500 shqiptarë, prej tyre rreth 2000 në qarkun e Odesës, dhe mbi 1000 në qarkun e Zaporozhjes dhe rreth 500 në qarqe të tjera, përfshirë këtu edhe shqiptarët që jetojnë në Krime. Shqiptarët në Ukrainë janë deklaruar se ruajtja e së folmes së shqiptarëve në qarkun e Odesës ishte më e theksuar dhe, sipas deklaratave të banorëve, theksohet se gjuha e tyre amtare është shqipja, kurse në qarkun e Zaporozhjes, më shumë se 200 veta janë deklaruar se gjuhë amtare e kanë shqipen, me të cilën ndërmjet tyre komunikojnë në jetën e përditshme.

Gjatë hulumtimeve që kam bërë në këtë rajon, kam konstatuar se në fshatin Karakurt, në familjet shqiptare, e folmja shqipe vazhdon të përdoret rregullisht nga përfaqësuesit e të gjithë brezave, përfshirë këtu edhe fëmijët. Madje, nënat e reja dhe gjyshtet preferojnë të flasin shqip me fëmijët e tyre, me qëllim që ata të mësojnë gjuhën e tyre amtare. Në fshatin Georgievka, brezi i vjetër dhe i mesëm e zotërojnë mjaft mirë të folmen e shqipes. Ndërsa mungesa e së folmes së rrjedhshme e gjuhës shqipe nga brezi i ri buron te përfaqësuesit e brezit të mesëm, që në fëmijëri nuk e kishin përballuar vështirësinë e së folmes.

Sepse, ata nuk ishin përpjekur shumë që fëmijëve të tyre t'ua mësonin të folmen e gjuhës amtare - shqipen, megjithatë të rinjtë vazhdojnë të vetëdeklarohen si shqiptarë dhe e vlerësojnë të folmen shqipe nga prindërit e tyre. Kjo do të thotë "kthimi" i mëvonshëm i brezit të sotëm te gjuha amtare dhe ruajtja e saj. E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, sikurse edhe e atyre në Bullgari, i përket toskërishtes së vjetër dhe zhvillohet në shkëputje nga arealja amtare gjatë periudhës pothuaj 6-shekullore. Meqë ngulitja e paraardhësve të shqiptarëve të Ukrainës nga trojet shqipfolëse ndodhi mjaft herët, në të folurit e tyre deri më sot paraqiten trajtat arkaike në fonetikë e në morfologji dhe ruhen tiparet dialektore të arealit "nënë".¹¹³

E folmja e shqiptarëve të Ukrainës ka tërhequr vëmendjen dhe interesimin e shkencëtarëve si një e folme, në sistemin e së cilës ruhen shumë arkaizma, që kanë rëndësi të veçantë për ndriçimin dhe për njohjen më të thellë të problemeve të historisë së shqipes. Për rikonstruktimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe, me traditat e saj të shkrimit relativisht të vona, materialet e dialektologjisë historike kanë rëndësi të dorës së parë.¹¹⁴ Pos kësaj, zhvillimi i së folmes së shqiptarëve të Ukrainës, që ndodhej në izolim të plotë prej masivit kryesor të shqipes dhe nën ndikimin e gjuhëve të huaja, paraqet një interes të madh si për dialektologjinë shqiptare, por edhe për teorinë e përgjithshme të kontakteve ndërgjuhësore.

E folmja e shqiptarëve të Ukrainës, duke u zhvilluar në kontakt të ngushtë me gjuhën ruse, gjuhën ukrainase, gjuhën bullgare dhe me atë gagauze-selxhuke-turke, jep material shumë të pasur për shqyrtimin e dukurive gjuhësore në aspektin e interferencës gjuhësore. E folmja e shqiptarëve të Ukrainës i përgjigjet në tërësi tipit dialektor të toskërishtes në gjendjen e saj arkaike. Mirëpo, në të njëjtën kohë atë e karakterizon edhe një numër i madh inovacionesh të lidhura si me zhvillimin e mëvonshëm të sistemit, ashtu edhe me ndikimin e gjuhëve që e kanë rrethuar atë. Arkaizma dhe inovacione vërehen në të gjitha rrafshet e sistemit të së folmes: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë dhe në rrafshin e leksikut.

Vite më parë me iniciativën e një grupi shqiptarësh të Karakurtit, busti i Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, është vendosur në qendër të fshatit Karakurt të Ukrainës. Ndërsa, falë bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Diasporës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Ukrainës, është bërë një program i përbashkët për mësimin e gjuhës shqipe në Ukrainë. Krahas kësaj, Ministria e Diasporës e Shqipërisë ka parashikuar dërgimin e librave shkollorë dhe një mësues të gjuhës shqipe për fëmijët e shkollës së fshatit Karakurt.¹¹⁵

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ I. Voronina, M. Domosileckaja, I Sharapova, *E folmja e shqiptarëve të Ukrainës*, Shkup, 1996, f. 18.

¹¹⁵ E. Çabej, Kolonitë e tjera shqiptare, *Studime gjuhësore*, III, Prishtinë, 1976.

Frymë atdhetare e shqiptarëve në Rumani

Edhe në Rumani, sikur në Bullgari e Ukrainë, jeton një komunitet i fuqishëm shqiptar, i cili me fanatizëm ka ruajtur gjuhën dhe identitetin kombëtar. Shqiptarët e vendosur në Rumani fillimisht kanë gjetur strehë në Konstancë, pastaj në Krajovë, në Bukuresht, në fshatin Sllatinë e në disa lokalitete të tjera rumune, duke krijuar edhe kolonitë e tyre. Sipas hulumtimeve të fundit që kam bërë në vitin 2005, kam vërejtur se para 150 vitesh numri i shqiptarëve të vendosur në truallin rumun sillej mbi 4 mijë veta; para 80 vitesh rreth 40 mijë; ndërsa sot, sipas regjistrimit të fundit, atje jetojnë pak shqiptarë. Gjatë hulumtimeve nëpër vendbanimet e përmendura shqiptare, banorët gjurmët i kanë ruajtur nëpërmjet kujtimeve nga stërgjyshërit, të cilat pasqyrojnë historinë interesante dhe domethënëse për ndodhitë në periudhat e caktuara. Shqiptarët e mbijetuar thoshin se pesë shekujt e kaluar në dhe të huaj, janë shekuj më të dhimbshëm të jetës së tyre.¹¹⁶

Në Bukuresht lindën dhe jetuan shumë personalitete të kulturës, të arsimit dhe artit shqiptar. Ndër ta dallohej Elena Gjika, mbretëresha shqiptare e kulturës evropiane, e njohur me emrin Dora D'Istria, që konsiderohet si njëra prej shqiptareve dhe publicisteve më të famshme shqiptare. Ajo ishte një përkrahëse e denjë e çështjes kombëtare shqiptare. Elena Gjika ka qenë njëra prej grave më të shkolluara shqiptare të kohës. Ajo komunikonte në shtatë gjuhë dhe kishte një vizion të qartë dhe një qëllim të lartë, duke u angazhuar për mbijetesën e kombeve të vogla.¹¹⁷

Braila në Rumani është qyteti ku jetoi dhe veproi shkrimtari shqiptar Naum Veqilharxhi, autor i abetares së parë në gjuhën shqipe. Interesimi dhe jehona që kishte bërë në mesin e shqiptarëve atje, Naumit i kishte dhënë kurajë dhe ia kishte shtuar edhe më shumë entuziazmin e punës, andaj edhe iu rrek përpilimit të një abetareje të re me titull “Fare i ri ëvetar shqip”, që ishte një tekst më i pëlqyer. Ekzistojnë argumente sipas të cilave rrënjët e atdhetarizmit të kolonisë shqiptare në Rumani janë mu në Brailë, ngase redaksia e gazetës së parë shqipe në Rumani, “Drita” përkatësisht “Lumnia”, botohej në Brailë.

Prandaj Braila mbetet në kujtesën historike si qytet i lindjes së abetares së parë shqipe. Gjithsesi, çështja e alfabetit të shqipes do të zgjidhej përfundimisht vetëm me Kongresin e Manastirit, që u mbledh më 22 nëntor të vitit 1908, ku u hartua një alfabet ri me shkronja latine i cili është në përdorim edhe sot. Nikolla Naço, në historinë e kolonisë së shqiptarëve në Rumani, njihet si nismëtar i hapjes së shkollës së parë shqipe në Bukuresht. Në vitin 1892, ai shpalli të hapur Shkollën Normale në gjuhën shqipe. Hapja e kësaj shkolle bashkë me konviktin në Bukuresht, në fakt, ishte e lidhur ekskluzivisht me veprimtarinë e shoqërisë “Drita”, me Nikolla Naçon në krye.

Në Rumani jetoi dhe veproi rilindësi i pavdekshëm dhe shkrimtari ynë i madh kombëtar, Asdreni, i cili është edhe autori i himnit tonë kombëtar. Ndërsa, në Konstancë jetoi dhe punoi edhe veprimtari i shquar shqiptar, Gjergj Bubani, i cili për shqiptarët në Konstancë dhe përgjithësisht në Rumani, kishte hapur një radio dhe kishte botuar një gazetë në gjuhën shqipe. Siç është e ditur, në hotelin “Kontinental” të Bukureshtit, u mbajt mbledhja historike për përcaktimin e fatit të Shqipërisë, ku në vitin 1912, një grup patriotësh me Ismail Qemalin në krye, pas mbledhjes së krerëve më të lartë të lëvizjes kombëtare, morën rrugë për në Vlorë ku edhe shpallën Pavarësinë e Shqipërisë.

Në metropolin rumun deri para dy vitesh jetoi dhe punoi lideri shpirtëror i shqiptarëve të Rumanisë, akademik Xhelku Maksuti, i konsideruar nga ata që e kanë njohur si ikonë e kulturës shqiptare në mërgim. Ai ka botuar në Rumani, në Kosovë, në Shqipëri dhe në Maqedoni, qindra studime dhe artikuj shkencorë mbi lidhjet rumuno-shqiptare.

¹¹⁶ Kurtesh Devaja, *Frymë atdhetare e shqiptarëve në Rumani*, 2010, f. 154.

¹¹⁷ Kristina Maksuti, *Elena Gjika dhe shqiptarët e Rumanisë*, Bukuresht, 2001, f. 56-57.

Në vitin 1993, akademik Xhelku Maksuti themeloi revistën “Albnezul” dhe bashkësinë kulturore të shqiptarëve në Rumani, të cilat po japin kontribut konkret në botimin e qindra numrave të kësaj tribune të famshme, si dhe të dhjetëra veprave shkencore dhe letrare autorësh shqiptarë dhe rumunë. Në Bukuresht jeton edhe veprimtari i devotshëm i çështjes kombëtare, Baki Ymeri. Ai ka dhënë dhe po jep një kontribut të jashtëzakonshëm për komunitetin shqiptar në Rumani. Me anë të shkrimeve dhe librave të tij, jo vetëm që ka afirmuar komunitetin shqiptar, por edhe ka kontribuar që komuniteti shqiptar në Rumani të mbijetojë e të mos asimilohet. Me fjalë të tjera, veprimtari Baki Ymeri tërë jetën e tij, që nga rinia e deri më sot, ia ka kushtuar afirmimit dhe ruajtjes së gjuhës dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve në Rumani.¹¹⁸

Përfundime

Në këtë artikull trajtuam çështjet dhe mënyrën e ruajtjes së identitetit kombëtar dhe gjuhës shqipe të komuniteteve shqiptare në Bullgari, në Ukrainë e Rumani. Shqiptarët që jetojnë në shtetet e përmendura konsiderojnë se ruajtja e identitetit kombëtar dhe e gjuhës amtare janë postulatet kryesore që i mbanë gjallë si shqiptarë, me gjithë vështirësitë e shumta që i përcollën e i përcjellin gjatë jetës së tyre. Edhe pse në mungesë të shkollave shqipe, komunitetet shqiptare në Bullgari, në Ukrainë e Rumani, duke folur gjuhën shqipe në familje, e mbajtën gjallë të folurit shqip. Shqiptarët në shtetet e përmendura, me qëllim të mbajtjes gjallë të identitetit, gjuhës e traditave shqiptare-kombëtare, formuan shoqata të ndryshme ku tuboheshin dhe i zhvillonin aktivitetet e tyre për mirëruajtjen e gjuhës dhe identitetit të tyre kombëtar.

Organizonin shoqata folklorike dhe argëtuese, ku nëpërmjet këngës dhe folklorit tradicional kontribuuan në ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar. Roli i tyre ishte me vlerë sepse kontribuonte në tubimin e tyre dhe pasurimin e gjuhës. Kjo ndikoi që kohët e fundit në Bullgari, Ukrainë e Rumani të hapen degë të ndryshme ku do të kultivohet gjuha shqipe. Gjuha e tyre është gjuha arkaike që e flisnin paraardhësit e tyre dhe gojë më gojë e trashëguan te pasardhësit të cilët sot e gjithë ditën në familje flasin shqipen arkaike. Kohët e fundit aty-këtu në Bullgari e Ukrainë kanë filluar në disa shkolla të ketë edhe lëndë mësimi jo të domosdoshme – vullnetarisht mësimin e lëndës së gjuhës shqipe, gjë që po kontribuon në afirmimin e gjuhës amtare te shqiptarët që jetojnë në ato vende.

Shqiptarët jashtë shtetit të origjinës, që sot jetojnë si në Bullgari, në Ukrainë, në Rumani e në vende të tjera, për shekuj me radhë kanë qenë të atakuar nga dy rrebeshe kohore të pandalshme dhe mezi kanë mbijetuar. Njëri ka të bëjë me asimilimin dhe tjetri me mohimin. Asimilimi, një proces i kushtëzuar nga më shumë rrethana, si i tillë bëhet shkaktar kryesor në shuarjen e cilido komunitet. Mendoj se nuk mund të shpjegohen ndryshe proceset asimiluese dhe shkrimet etnike që ka ndodhur për shekuj me radhë në shtetet e përmendura. Përmes këtij publikimi në formën e shkruar u mundova sadokur të shpreh fatin e dhimbshëm të shqiptarëve që jetojnë në Bullgari, Ukrainë dhe Rumani, të cilët bëjnë çmos të ruajnë gjuhën, traditën, kulturën, historinë dhe vlerat e tjera të tyre të përbashkëta.

Aq më shumë, pasi kjo ka dëshmuar se asnjë furtunë e kohës nuk ka mundur t'i shlyejë nga ata, disa tipare që i bëjnë t'i njohësh kudo që janë. Është ky fat i gjendjes së tyre shpirtërore dhe sociale, që dita-ditës u kanoset rreziku i asimilimit, të cilin ata nuk e dëshirojnë dhe të cilit i frikësohen. Këta njerëz të përloitur e të përmalluar për tokën e stërgjyshërve i mban shpresa se gjurmët e të parëve që vdiqën me mall për atdheun e të parëve dhe gjithë ata që janë në jetë, nuk do të harrohen, por vlera e thesarit arkivor që mbeti pas tyre, do të ruhet me respekt e dashuri për punën e çmuar që bënë me shekuj në dhe të huaj për të mirën e kombit.

¹¹⁸ Kurtesh Devaja, *Fryma atdhetare e shqiptarëve* të Rumanisë, 2010, f. 267.

Referencat

- [1]. *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, përgatitur nga N. R. Çabej, Prishtinë, 1994.
- [2]. Domi, Shuteriqi, 1965.
- [3]. Devaja K. *Me shqiptarët në Bullgari*, 2018.
- [4]. Islami S., BSSH, nr. 2, 1955.
- [5]. Sokollova Bojka, *Komuniteti shqiptar në Bullgari*, 1979.
- [6]. Sharapova L. *Osnoviji balkanskogo jazikoznanja*. C.I. *Jaziki balkanskogo regiona*, Leningrad, 1990.
- [7]. Hoxhaj S. *Shkrime për shqiptarët në Bullgari*.
- [8]. Stankov L. *Gjuha shqipe, E folmja e shqiptarëve në Bullgari*.
- [9]. Georgieva Marija, *Fjalori bisedimor bullgarisht-shqip*.
- [10]. Jereček Konstantin, *Studim mbi shqiptarët në Bullgari*, 1950.
- [11]. Anamali S. – *Karakurti., Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve në dritën e*
- [12]. *kërkimeve arkeologjike shqiptare, ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Tiranë, 1969.
- [13]. Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë.
- [14]. Arkivi i Kosovës, Prishtinë.
- [15]. Iz istorije Albanaca, Beograd, 1969, f. 21, 22).
- [16]. Ispisi iz Vatikana (Arkiv SAN), sv, dok, br, 89; sv.V. dok. br.110.
- [17]. Dokumente të sjella nga Arkivi i Vjenës, të përkthyer në gjuhën shqipe, të periudhës 1875-1912.
- [18]. Raporte të konsujve të jashtëm dhe materiale të ndryshme për periudhën 1910-1912.
- [19]. Shehu, B. *Çështjet shqiptare në fillim të viteve '30 të shekullit XIX*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990.
- [20]. Denko L.J. *Albanskij govor s. Karakurt (fonetik, morfologjia imeni gllagolla)* Avtoreferat kand. Disertacij. 1974
- [21]. Demetli F. *Duke fletuar fletët e kujtimeve*, (Përkthim A. Shost).
- [22]. Dugushina A. *Ritet e lindjes ndër shqiptarët e Ukrainës*, Universiteti i Petërburgut.
- [23]. Esina E. *O nekolorij tipa artiklev v allbanskom govore s. Karakurt – Sankt Peterburg*.
- [24]. Voronina I. *Sintaksiçeskie funksii prilagatel'nogo v govore allbancev Ukrainji*, 1970.
- [25]. Skallskovsij A. A. *Opjit statističedskogo opisanja Novorosiskogo kraja Odessa*, 1950.
- [26]. Predesku C. *Albanezul*, Bukuresht, 1895.
- [27]. Naum A. *Atdheu ser.II-të*, Konstancë, 1935.
- [28]. Bubani Gj. *Brumbullu*, 1930.
- [29]. Germezi Th. E. *Bleta*, Konstancë, 1923.
- [30]. Maksuti K. *Influente culturale Romano-Albaneze*, Bukuresht 1995.
- [31]. A. Grun, *Drita*, Brail, 1887.
- [32]. Maksuti K. *Dora D'Istria*, Bukuresht, 2005.
- [33]. Popesku E. *Daca*, Bukuresht, 2009.
- [34]. Domi M. *Mbi jehonën e botimit të Abetarit shqip dhe veprimtarisë së Naum Veqilharxhit në shtypin rumun*, në Studime historike, Tiranë 1976.